



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 481/2023
Datë: 26 qershor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 27 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 26 qershor 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Propozim për lirim nga detyra e prokurorit të Shtetit për z. Haki Gecaj, për arsye të arritjes së moshës së pensionimit.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Me datë 03 korrik 2023 z. Haki Gecaj, prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, arrin moshën e pensionimit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës i propozon Presidentes së Republikës së Kosovës, që në kuadër të kompetencave kushtetuese të parapara në nenin 84 paragrafi 18, të Kushtetutës, të lirojë z. Haki Gecaj nga detyra e Prokurorit të Shtetit.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Haki Gecaj;
- Zyrës së Presidentes së Kosovës;
- Sekretariatit dhe dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.

